



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RRESHEN

NR 4332 PROT

RRESHEN ME, 12/12/ 2014

KONTRATË
PËR KRYERJE MBIKOYRJE TË PUNIMEVE

OBJEKTI:

**“ RIKOSTRUKSION I RRUGES NGA URA E VARREZAVE-URA
E PAZARIT UNAZA E MADHE RRESHEN “**

Adresa: Sheshi Abat Doci Rreshen , Mirditë, Shqipëri

“RIKOSTRUKSION I RRUGES NGA URA E VARREZAVE-URA E PAZARIT UNAZA E MADHE “
BASHKIA RRESHEN



103

KONTRATË PËR KRYERJE MBIKOYRJE TË PUNIMEVE

OBJEKTI: "RIKOSTRUKSION I RRUGES NGA URA E VARREZAVE-URA E PAZARIT UNAZA E MADHE RRESHEN"

Kontratë e lidhur sot me datë 12 / 12 / 2014, midis investitorit Bashkia Rreshen dhe mbikqyrësit të punimeve shoqërin ERALD-G me nipt **K36306784K** përfaqësuar nga Ing. Gezim Islami, i licencuar, "Për mbikqyrje dhe kolaudim punime ndërtimi", lëshuar nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, një kopje të së ciles e mban investitori. **ME NR. MK.1015/6 DATE 01.07.2013. ME AFAT VLESHMERIE 15.11.2020**

I-Objekti i kontratës

Mbikqyrje e punimeve të objektit "RIKOSTRUKSION I RRUGES NGA URA E VARREZAVE-URA E PAZARIT UNAZA E MADHE RRESHEN"

II-Të përgjithëshme

- 1- Mbikqyrësi i punimeve do të ushtroje aktivitetin e tij në përputhje të plotë me ligjin Nr. 8402, Datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" me ndryshimet përkatëse si dhe Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr.3, Datë 15.02.2001 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"
- 2- Mbikqyrja e punimeve për objektin në fjalë ka për qëllim kontrollin dhe mbarëvajtjen e gjithë procesit të zbatimit të punimeve, bazuar në projekt-zbatimin, K.T.P dhe K.T.Z.
- 3- Paguesa e supervizorit përcaktohet sipas ofertes se tij ne prokurimi e zhvilluar, dhe per objektin ne fjale do te jete **399 600** (treqindetridhjetenetemije e gjashteqind) lek me tvsh.
- 4- Mbikqyrësi i punimeve është i detyruar të njohë dhe të veprojë në praktikë konform të gjitha detyrimeve që ka ai nga zbatimi i ligjit Nr. 8402, Datë 10.09.1998, kreu I, II, III si dhe Udhëzimit të KM Nr.3, Datë 15.02.2001, kap. I pikat 1 deri 21, mos zbatimi i tyre përbën shkelje dhe mbi të veprojnë sanksionet sipas nenit 15-17 të ligjit Nr. 8402, Datë 10.09.1998.
- 5- Ne veçanti mbikqyrësi i punimeve, që të ushtrojë veprimtarinë e tij, nuk duhet të ketë asnjë lidhje interesi me zbatuesin e objektit dhe per këtë deklaron me përgjegjësi personale para fillimit të punës.

III-Të veçanta


A-Detyrimet e investitorit

- 1- Investitori do të bëjë pagesën ndaj supervizorit në çdo fund muaji, e përllorësitur mbi bazën e situacionit të punimeve të paraqitur nga sipërmarrësi.
- 2- Investitori do të pergatisë dhe të pajisë mbikqyrësin e punimeve me dosjen teknike të objektit.

B-Detyrimet e supervizorit

- 1- Mbikqyrësi i punimeve është një ndër personat kryesor dhe përgjegjës për ndërtimin e objektit.
- 2- Mbikqyrësi mban, kontrollon dhe përgjigjet për dokumentacionin bazë si: Projekt-zbatimin dhe preventiv-zbatimin, që janë të firmosura nga projektuesi.
- 3- Për punimet e maskuara si: Të dhënat topografike, gjeologo-inxhinierike, të themeleve, betonimeve, punimeve hidro sanitare, tokëzimi si dhe punimet e tjera të percaktuara si të maskuara mban proces-verbalet përkatëse.
- 4- Kontrollon plan-organizimin e punimeve si dhe dokumentat për ndryshimet e mundëshme që mund të bëhen gjatë ndërtimit.
- 5- Kontrollon librin e kantierit dhe përgjigjet për vertetesine e dokumenteve.

"RIKOSTRUKSION I RRUGES NGA URA E VARREZAVE-URA E PAZARIT UNAZA E MADHE"
BASHKIA RRESHEN



6- Verifikon licencat.

7- Duhet të njohë mirë kushtet e kontratës së sipërmarrjes të përcaktuara më hollësisht në Udhëzimin e KM Nr. 3, Datë 15.02.2001 në pikat 6-19.

8-SIGURIMIN E KONTRATES NE VLEREN 39 960 LEKE (TRIDHJETENETEMIJE E NETEQIND E GJASHTEDHJETE)

9-AFATI I KESAJ KONTRATE ESHTË DERI NE PERFUNDIMIN E PUNIMEVE TE OBJEKTIT

III-Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të kësaj kontrate, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim midis paleve, palët i drejtohen Gjykatës së rrethit Gjyqësor Lezhë.

Kjo kontratë hartohet në tre kopje të barabarta dhe nënshkruhet nga palët kontraktuese.

MBIKQYRESI


INVESTITORI

SHOQERIA ERALD-G
Ing Gezim ISLAMI

BASHKIA RRESHEN

Gezim Islami

KRYETAR
NDUE GEGA



ADRESA: SHESH ABAT DOCI RRESHEN, MIRDË

“RIKOSTRUKSION I RRUGES NGA URA E VARREZAVE-URA E PAZARIT UNAZA E MADHE “
BASHKIA RRESHEN

